

# QESHTEJET E FEED-IN TARIFFËS PËR HIDROCENTRALET E VOGLA

## KOMENTET DHE REKOMANDIMET E KEK-UT

### 1. PËRMBLEDHJE

Qeveria e Kosovës ka si politikë të ripërtërirë<sup>1</sup> të inkurajoj zhvillimin e projekteve për Hidrocentrale e Vogla (HCV) si dhe alternativat tjera. Politika përfshin zhvillimin Feed-in për HCV-të. Si blerësi potencial dhe i kërkuar i energjisë nga HCV-të, Korporata e Energjisë e Kosovës (KEK) ka një ndikim në sasinë, kualitetin koston e energjisë, në mbrojtjen e konsumatorëve të vet dhe në mundësinë për të furnizuar energji elektrike. Qartazi, KEK-u ka nevojë për burime të reja dhe të përbalueshme të energjisë elektrike dhe HCV-të mundësojnë këtë sidhe kualitet tjera atraktive për të shërbyer dhe për ta forcuar rrjetin e energjisë elektrike brenda vendit.

ZRrE-ja ka lëshuar një Raport Konsultativ, Shqyrtimi i Tarifës Fikse për Projektin e Hidro-Energjisë., dhe ka pasur një takim për të diskutuar tarifën e propozuar dhe llogaritjen e kostove bazë të tarifës. Komentet në raport si dhe konsideratat tjera për interesimin e ZRrE-së në rregullimin e feed-in tarifës për HCV-të janë të dhëna në këtë dokument.

Komentet dhe rekomandimet e KEK-ut janë të paraqitura këtu ashtu siç janë kërkuar nga ZRrE-ja. Ato fillimisht janë përqendruar në adresimin e çështjeve me rëndësi kryesore për ndërmarrjen që do t'i kërkohej të blej energjinë dhe kalimin e kostos te konsumatorët. Fokusimi kryesorë është që të kemi në dispozicion prodhimin e HCV-ve në kohët kur është i nevojshëm dhe me një çmim i cili nuk do i ngarkonte konsumatorët. KEK-u e di që aksionarët e tjerë kanë shumë probleme ligjore duke përfshirë ato ambientale, sociale, pajtueshmëri me Udhëzimet e BE-së, dhe problemet tjera të politikave. KEK-u e di që brengat e të gjithë aksionarëve duhet të merren nga ZRrE-ja për të arritur te një feed-in tarifë,

Treguesit kryesorë për tarifën e HCV-ve që kanë ndikim në KEK dhe në Konsumatorë janë:

- Koordinimi kohorë i furnizimit mujor me energji është i rëndësishëm dhe nëse nuk caktohen me kohë kufizimet në sasinë e energjisë që e japin HCV-të gjatë periudhës me tepriçë të energjisë Prill-Qershor, atëherë tarifa për atë periudhë duhet të jetë shumë e ulët.
- Struktura tarifore duhet të mundësoj inkurajimin e ndërtuesve të HCV-ve për të planifikuar dhe dizajnuar projektet e tyre për të dhënë sa më shumë energji elektrike që është e mundur gjatë pikut dhe për ti shpërblyer furnizuesit që furnizojnë një energji të tillë elektrike. HCV-të shpesh nuk janë në gjendje të

---

1. <sup>1</sup> Vendimi Politik I Qeverisë së Kosovës 05/250 I datës 16 Maj 2007; “Masat Nxitëse për Gjenerimin e Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtrishme dhe Bashkë-gjenerimi.”

rezervojnë ujë por shumica munden përmes rezervarëve ose puseve grumbulluese dhe nuk duhet të supozohet se një zhvillim i tillë nuk është i mundur.

Ekziston një brengë sa i përket sasisë dhe kohës të energjisë nga HCV-të. Për shkak të Hidrologjisë në pjesën më të madhe të Kosovës, nëse HCV-të nuk janë të madhësisë së duhur, do të japin një përqindje të dukshme të energjisë së tyre gjatë shkrirjes së dëborës – periudhat nga Prilli deri në Qershor, kurë edhe KEK-u e edhe rajoni kanë teprice të energjisë. Kështu që, vlera e asaj teprice të energjisë është relativisht e ulët. Në tarifa duhet të merret në konsideratë eliminimi i pagesës së tarifave të larta të HCV-ve për kualitet të ulët të energjisë që i jepet KEK-ut dhe Rajonit.

Ekziston një numër i krahasimeve zhvillimore për vendosjen e Feed-in Tarifës për HCV-të. Këtu përfshihen kostot e tanishme të blerjes së energjisë elektrike (dhe shitjes) sidhe pagesat për hidrocentralet ekzistuese dhe kostot e prodhimit në blloqet e lignitit. Poashtu relevante janë edhe feed-in tarifat për HCV-të në vendet fqinje Shqipëri dhe Maqedoni ku tarifat duket të sillen rreth €45 deri 80 për MWh.

## 2. ÇËSHTJET LIDHUR ME PROJEKTET E VOGLA TË HIDROS NË SISTEMIN E KEK-UT

Vendimi Politik i Majit 2007 vendos konceptin e çmimit nxitës dhe kontratat ‘merre ose paguaj’ nga KEK-u ose furnitorët tjerë publik për bashkë-gjenerim dhe energji elektrike të ripërtrishme. Çmimet akoma nuk janë të caktuara dhe ka të ngjarë të jenë subjekt i një debati dhe kundërshtimi të madh. Politika poashtu sugjeron maksimizimin e të hyrave për Buxhetin e Kosovës nga vendimet e duhura për burimet e ujit në lokacionet që do zhvillohen.

Derisa KEK-u blen energji nga HCV-të, duhet të siguroj dy artikuj për të mbrojtur konsumatorët e vetë:

- Energjia elektrike është e përdorshme në sistem dhe mund të përcillet lehtë dhe,
- Energjia elektrike duhet të jetë në një normë të blerjes që është brenda kufijve të kostove alternative, plus ç’fardo ngritje që mund të justifikohet me gjenerimin e ripërtërishëm dhe të shpërndarë;

Caktimi i tarifës për energji elektrike dhe kërkesave për blerje sipas definicionit “merre ose paguaj”, sigurisht që to ketë ndikim në shfrytëzimin energjisë nga HCV-të që i jepet KEK-ut.

## 3. KOORDINIMI KOHOR I FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIK NGA HCV-TË

Ekziston një problem i mundshëm me një feed-in tarifë të vetme për tërë energjinë nga HCV-të. KEK-u tani për tani ka burimin e tij kryesorë në njësit e mëdha të djegies së lignitit që nuk mund të qarkullohet lirë apo lehtë. Problemi i menaxhimit të ngarkesës tashmë është i rëndësishëm në përmbushjen e ngarkesës ciklike me blloqe jo-cikluese.

HCV-të do ta shtojnë këtë problem deri në një masë. Është e pamundur, pa ndonjë stimulim të dukshëm, që blloqet e HCV-ve me 'rrjedhje lumi' mund ose do të japin energji elektrike gjatë pikut ose energjie elektrike maksimale gjatë sezonit me kërkesë të lartë. Në një sistem të furnizimit me energji elektrike me blloqe relativisht të mëdha të shpërndarjes së shpejt, siç janë projektet e hidro-energjisë me akumulim sezonal apo vjetorë, sistemet më pak të shpërndashme mund të jenë më të përshtatshme për tu futur në sistem. Uzinat me akumulim mund të mbajnë ujë deri në kohën kur uzinat tjera kanë prodhim të ulët ose pa prodhim fare, duke e mbuluar tërë sistemin. Megjithatë, Kosova nuk ka ndonjë mundësi të madhe për të akumuluar ujë ose të kursej derivate të shpërndarjes, duke e zvogëluar kështu vlerën e burimeve të gjenerimit me shpërndarje më të vogël ose me parashikim më të vogël siç janë hidrocentralet e vogla ose era.

Disa Hidrocentrale të vogla mund të bëhen më të përdorshme të paktën në baza ditore ose javore, nëse përfshin të paktën akumulim e kufizuar për të lëshuar rrjedhat gjatë kërkesës së pikut. Njohja e vlerës së shpërndarjes dhe definicioni i nevojës minimale do të jetë i vlefshëm nëse përfshihet në caktimin tariforë. Një ndërtues i projektit ka nevojë të përcaktoj nëse një akumulim dhe harxhim i tillë mund të futet në kostot dhe ndalesat ambientale të projektit.

### 3.1 – FURNIZIMI TEPRICË NGA HCV-të Prill deri në Qershor

Problemi më i rëndësishëm mund të jetë në sezonën kur ngarkesa e KEK-ut është e tej-përmbushur. Figura 1 është tabela e përdorimit mujor të totalit të energjisë për 2006. Kërkesa për energjinë mujore zbrit dukshëm në Prill, Maj dhe Qershor, drejt së ultës në Korrik dhe pastaj ngritët prapë drejt muajve të pikut Dhjetorë dhe Janar.

Hidrologjia për shumicën e lumenjve ku HCV-të janë më atraktive, për fat të keq i përgjigjen periudhës Prill – Qershor kur ka zvogëlim të kërkesës. Tabela 1 Përfshinë disa mostra të rrjedhës mujore të lumenjve për HCV-të të cilat janë zgjedhur si atraktive në Studim. Këta shembuj në përgjithësi paraqesin hidrologjinë në rajon sidhe në Kosovë.

Nëse HCV-të janë të ndërtuara (fuqia e instaluar) për një rrjedhje të madhe të periudhës Prill-Qershor, shumica e energjisë nga këto blloqe do të furnizohej gjatë atyre muajve. Gjatë muajve me kërkesë të ulët dhe me rrjedhë të lartë, energjia ekstra ka vetëm vlerë të bashkimit dhe edhe mund të nevojitet që të shitet te sistemet tjera. Shitja jashtë Kosovës gjatë këtyre muajve nuk do të jetë e lehtë pasi që rajoni që e rrethon e i cili varet nga Hidro poashtu do të ketë mjaftë energji. Tarifat e marra për energjinë elektrike do të jenë mjaftë të ulëta në tregun e shkëmbimit tariforë.

Si rezultat, është e rëndësishme që uzinat të planifikohen në atë mënyrë që energjia elektrike ose të jepet gjatë pikut, në baza ditore OSE madhësia e bllokut të jetë e kufizuar ashtu që energjia elektrike e furnizuar gjatë muajve me kërkesë të ulët të jetë e kufizuar.

Si shembull, Projekti ekzistues i Lumëbardhit edhe në vitin 2006 dhe 2007 ka dhënë mbi 56% të energjisë elektrike vjetore në tre muajt nga Prilli deri në Qershor. Si njëri nga tri çereket, koha paraqet vetëm 25% të ati viti . Trend të ngjashëm do ketë edhe në vitin 2008. Hidrologjia në disa por jo në të gjithë lumenjtë që i mbështesin HCV-të në Kosovë është e njëjtë.

Është e mundur që problemet financiare të KEK-ut mundë të përkeqësohen me teprica të energjisë elektrike nga HCV-të në çerekun e dytë të vitit. KEK-ut do i duhet të shesë energji elektrike kur sistemet tjera kanë tepricë të ngjashme në Prilli deri Qershor nga rrjedha e ujit pranverorë, dhe ka nevojë për energji elektrike kur ajo është e shtrenjtë, mund të keqësohet me tepricën e energjisë elektrike nga HCV-të. KEK-u mund të blej energji elektrike me një tarifë nxitëse prej €50-70/MWh ose më shumë dhe njëkohësisht ta shesë atë me €15 MWh ose me një tarifë falas. Në një ndërmarrje të madhe dhe financiarisht të shëndoshë, efekti mund të jetë neglizhent. Megjithatë për KEK-un ka një rrjedhje negative të parave dhe menjëherë do t'i ngrit tarifat për konsumatorët Kosovarë. Konsumatori mund të jetë duke pagurë në premium për tarifën nxitëse.

FIGURA 1  
Energjia e KEK-ut

Ngarkesa Mujore, 2006




Tabela 1 - Shembull i Hidrologjisë për HCV-të e Mundshme

Kuqishta SHPP													
Muaj	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Q	2.54	2.31	3.65	9.1	12.3	4.93	1.72	1.07	1.31	2.17	3.74	3.13	4.00
m <sup>3</sup> /sek.													

Bellaje HV													
Muaj	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Q	1.85	1.93	2.48	5.53	9.76	6.41	2.65	1.47	1.62	2.32	2.85	2.22	3.42
m <sup>3</sup> /sek.													

Burimi: Studimi paraprak i mundësisë për HCV në Kosovë

Lokacioni i mundshëm për HV të Bellajes gjendet në veriperëndim të Deçanit. Do të zhvilloj rreth 5.2 MW të energjisë elektrike nën HCV ekzistues të Lumëbardhit (Kozhner). HV i Kuqishtës ndodhet në rreth 17 km në veriperëndim të Pejës. Do të zhvilloj rreth 3.9 MW duke përdorur rrjedhat e Lumëbardhit Lumi i Pejës dhe është më së larti nga të tri lokacionet e HCV-ve në lumë.

### 3.2 ZGJIDHJE PER TEJ-FURNIZIMIN SEZONAL

Ka disa zgjidhje relativisht të thjeshta për këtë problem. Ndoshta më e thjeshta është që të kufizohet energjia elektrike që duhet të blihet nga HCV-të gjatë periudhës së rrjedhës së lartë. Së dyti do ishte kufizimi i faktorit të uzinës për HCV dhe së treti do ishte të paguhet më pakë gjatë çerekut të dytë.

Si shembull, për kufizimin e energjisë elektrike energjisë totale që duhet të blihet nga HV-të gjatë periudhës Prill –Qershor mund të kufizohet në jo më shumë se 40% e tërë prodhimit gjatë tërë vitit. Çereku nga Prilli në Qershor është 25% e kohës. Derisa 40% mund të duket një cak i lartë, zvogëlimi i caktut do i shkaktonte HCV-ve vështërsi të mëdha gjatë viteve të thata dhe poashtu mund ta bëjë projektin aq të vogël sa që nuk do të përfitonte gjatë viteve me rrjedhje të mirë kur do të prodhohej energjia e vlefshme.

Një rregullim i dytë i mundshëm do ishte të kufizohet faktori i uzinës i projekteve në ndonjë përqindje të caktuar – si 50-60% - për të kufizuar kapacitetin. Një rregullim tjetër i mundshëm mund të ketë tarifa dy pjesëshme bazuar në prodhimin e pritur dhe hidrologjinë. Megjithatë këto janë më të vështira për tu administruar.

Rregullimi më i thjesht për tej-furnizimin sezonal është që ofrohet një normë më e ulët për çerekun e fundit si përqindje e normës së plotë të vlerës. KEK-u rekomandon që norma të caktohet në 50% të normës së tre çerekëve të mbetur të vitit. Pagesa më e ulët për energjinë elektrike të panevojshme është bërë në shumë vende me sezon të lagët/thatë dhe nuk është e pazakontë

Më në fund, mund të ketë zgjidhje tarifore në pik/jashtë pikut që i jepet prodhuesit.. Shtimi i një dige për të mbledhur ujin për pikun i shtohet koston së projektit dhe shton edhe dimensione tjera sociale që duhet të zgjidhen (ambienti, siguria në digë, rivendosja e banorëve, etj.). metoda e thjeshtë do ishte të paguhet një shumëzim më i lartë i tarifës bazë gjatë orëve të pikut.

Si përmbledhje, KEK-u rekomandon që norma tarifore për HCV-të të strukturoret në atë mënyrë që periudha Prill-Qershor të pasqyroj vlerë më të vogël të energjisë elektrike gjatë kësaj periudhe. Rekomandohet një normë 50% në tarifën bazë të HCV-ve

### 4. KONSIDERIMI I TARIFES FIKSE PËR HCV-të

Vendimi i Qeverisë së Kosovës 05/250 ka vendosur nevojën në caktimin e çmimit për blerjen e energjisë elektrike nga ZRrE-ja. Është e qartë se KEK-u ka interes në çmim dhe vazhdon të favorizojnë një zgjidhje të shpejt dhe adekuate që ta aktivizoj industrinë e HCV-ve. Derisa të rregullohen çështjet tarifore, nuk do të ketë aktivitet në sektor. KEK-u e mbështet një tarifë që do përfshinte llogaritjet për kostot e mënjauara nga hidrocentralet e vogla, disa nxitës për energji elektrike vendore dhe të ripërtrishme dhe ca njohje të vlerës të energjisë elektrike që mund të shpërndahet në rrjet.

Raporti Konsultativë i ZRrE-së mbi Tarifën Fikse për Hidrocentralet e Vogla merr një qasje të llogaritjes së tarifës duke u bazuar në kostot e HCV-ve treguese nga një studim i më hershëm hulumtues. Studimi hulumtues, Referenca 2, ka qen një studim hulumtues për të identifikuar potencialin e HCV-ve dhe për të sugjeruar lokacionet më të mira për

zhvillim. Raporti Konsultativë përdor kostot nga studimi për të zhvilluar një tarifë nxitëse të HCV-ve si në vijim:

<i>Fuqia e Instaluar</i>	<i>Tarifa (Eurocent/kWh)</i>
<i>Hidrocentralet deri në 2MW</i>	<i>6.44</i>
<i>Hidrocentralet nga 2MW deri në 5 MW</i>	<i>5.02</i>
<i>Hidrocentralet nga 5MW deri në10 MW</i>	<i>4.02</i>

Qasja për të përdorur një tarifë fikse nxitëse për HCV-të që krahasohet me përpjekjet për një kosto të bazuar në tarifë për secilën uzinë në vendet tjera ka dëshmuar të jetë një metodë efektive në tërheqjen e investimeve për HCV-të në projektet ekonomike. KEK-u pajtohet që një tarifë e ofruar ose një strukturë e caktuar tarifore është e përshtatshme për KEK-un dhe konsumatorët e KEK-ut.

Poashtu është e saktë që një tarifë e bazuar në kosto është një metodë e mirë caktuar një tarifë bazë. Megjithatë kostoja e mundshme për një zhvillim të tillë është vetëm një interesim nga disa të tillë që duhet të përfshihen në caktimin tariforë. Interesimet tjera duhet të përfshijnë vlerën e energjisë elektrike në sistem dhe inkurajimi i energjisë elektrike më të shfrytëzueshme nga HCV-të.

#### 4.1 Energjia Elektrike e Prodhuar

Kostot aktuale të energjisë elektrike të mënjauara nga KEK-u janë shumë të vështira të përcaktohen me saktësi dhe janë subjekt i shumë çështjeve dhe keq konceptimeve. Shpesh është menduar që kostot e mënjauara janë thjesht kostot e paguara nga konsumatorët, por kjo është gabim sepse tarifa e pakicës përfshin shumë kosto duke përfshirë transmisionin, shpërndarjen dhe shpenzimet tjera me radhë. Kostot e mënjauara zakonisht janë kostot e mënjauara të prodhimit nga burimet alternative.

Shumica e energjisë e prodhuar për sistemin e KEK-ut vjen nga Njësit e Kosovës me Lignit. Është e diskutueshme nëse dhe sa nga këto kosto mund të mënjahen duke blerë nga hidrocentralet e vogla, mund të jenë të vogla sa kostot e derivateve, por e lartë sa kostoja totale e prodhimit. Kostot e përgjithshme të prodhimit në uzinë janë të vlerësuara rreth €23-30/MWh, varësisht nga artikujt e përfshirë në kosto.

KEK-u blen energji elektrike nga dy hidrocentrale. Hidrocentrali i Ujmanit është 32 MW dhe mund të jap energji elektrike bazë dhe ca energji elektrike në pik. Ngarkesa bazë e energjisë elektrike që gjenerohet nga uji duhet të blihet rreth €22/MWh dhe €40/MWh për energjinë elektrike të (shpërndarë) nga KEK-u. Këto çmime nuk duken të larta krahasuar me njësit tjera, por projekti është ndërtuar dhe financuar para shumë vitesh.

Projekti Kozhnjer/Lumbardhë në mënyrë ekstensive është rehabilituar dhe është kthyer në shërbim sipas një tenderi konkurrues, që është kompletuar në vitin 2006. Çmimi i

mirë i ofruar për furnizimin me energji elektrike ka qen €40/MWh. Ky çmim duhet të konsiderohet për krahasim, por projekti ka qen një rehabilitim ekstensiv, e jo një projekt tërësisht i ri. Çmimi është i përshtatshëm pasi që ishte rezultat i një procesi tenderues dhe si i tillë ka qen i caktuar në mënyrë garuese.

#### 4.2 Energjia Elektrike e Blerë

KEK-u poashtu blen dhe shet energji elektrike nga burimet ndërkombëtare. Në këtë treg, KEK-u duhet të paguaj si për koston e energjisë elektrike edhe për transmisionin deri te pika e marrjes, në kufi. Kostot pasqyrojnë edhe koston e lartë të prodhimit dhe konkurrencën për energji elektrike. Kjo energji elektrike blihet përmes procesit të tenderimit për periudha të ndryshme kohore sipas disa kushteve të caktuara të furnizimit, por shpesh për 16 orë/ditë të furnizimit. Gjatë zezonës së kërkesës së ulët, KEK-u e shet në tregun ndërkombëtar energjinë elektrike jashtë pikut, natyrisht me çmime shumë më të ulëta sepse sistemet fqinjë në përgjithësi nuk kanë nevojë për energji elektrike në kohët jashtë pikut.

Kostot e energjisë elektrike janë ngritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit. KEK-u tani zakonisht paguan deri në €90-100/MWh për gjenerimin e energjisë elektrike në blloqet e mëdha. Teprica e energjisë elektrike e shitur zakonisht sillet rreth €30.

Këto kosto të burimeve të tanishme të energjisë elektrike janë krahasuar për një tarifë fikse të HCV-ve. Asnjë nga kostot nuk janë drejtpërdrejt të aplikueshme. Për shembull, çmimi blerës për energjinë e importuar është shumë i lartë sepse nuk aplikohet gjatë tërë vitit, dhe as në periudhat e jashtë pikut kur HCV-të akoma to jepnin energji. Poashtu është një çmim shumë i lartë që mund të rezultojë në përfitime të jashtëzakonshme për HCV-të në kurriz të konsumatorëve të KEK-ut.

#### 4.3 Tarifat Fikse të Vendeve Fqinjë

Që të dyja Shqipëria dhe Maqedonia kanë mungesë të energjisë elektrike dhe blejnë energji elektrike në tregun ndërkombëtar. Që të dy vendet veç i kanë vendosur tarifën fikse dhe në mënyrë agresive janë duke inkurajuar zhvillimin e hidro-energjisë.

##### Tarifa Fikse e Shqipërisë

Shqipëria ka caktuar një çmim të tarifës fikse për projektet e reja të furnizimit të energjisë nga HCV-të që është e barabartë me mesataren e çmimit importues here një faktor të 1.1. Në vitin 2007 çmimi i tarifës fikse ka qen €47/MWh. Për vitin 2008 tarifa fikse është e raportuar rreth €90/MWh. Besohet se tarifa ndërron çdo vit. Kështu që mund të jetë subjekt i një zbritje të ndjeshme kur të përmirësohet furnizimi me energji elektrike në Ballkan.

##### Tarifa Fikse e Maqedonisë

Maqedonia është në proces të ofertave të tenderit për ndërtimin e HCV-ve. Rreth gjashtëdhjetë projekte të vogla janë tenderuar me pjesëmarrës ndërkombëtar dhe vendorë. Hollësitë nuk janë të mundshme në këtë kohë, por se tarifa fikse është llogaritur veçmas varësisht nga rrethanat dhe raportohet të sillet rreth €45/MWh deri €80/MWh. Tarifa fikse është caktuar për 20 vite me tender.

#### 4.4 Llogaritja Tarifore e Raportit Konsultativë

Raporti Konsultativë i ZRrE-së për Feed-in tarifat përdorë një llogaritje të kostos për të përcaktuar tarifat e mundshme. Caktimi i tarifave të aplikueshme direkte, të qarta dhe universale ka dëshmuar të jetë një metodë efektive për të inkurajuar zhvillimin e HCV-ve në shumë vende. Poashtu është një mënyrë transparente për autoritetet rregullative dhe ndërmarrjet blerëse që t'i qasen zhvillimit të energjisë së vogël të ripërtrishme nga sektori privat.

Kostot e llogaritjeve për zhvillim janë në të vërtetë një interesim i përshtatshëm për të arritur të një tarifë, si dhe aplikimi i nxitjeve për të promovuar zhvillimin dhe për të përmbushur objektivat e politikës. Megjithatë duhet të kihet kujdes në përdorimin e llogaritjes së kostos direkt nga kostot e studimit hulumtues. Vlerësimet e kostos së studimit hulumtues janë zhvilluar për shumë lokacione dhe janë vetëm kosto nxitëse të cilat nuk do të thotë se janë një vlerësim i saktë për ndonjërin prej lokacioneve. Asnjë planë i hollësishëm specifik nuk është zhvilluar për lokacionet individuale. Asnjë e dhënë e kostos, përveç vlerësimeve si një linjë e vetme e kostos nuk është në dispozicion.

Për më tutje, rritjet e fundit të materialit the jo-stabiliteti i kostos kanë një ndikim serioz në kostot për ndërtimin e HCV-ve, e në veçanti në kostot e çelikut dhe derivateve që përdoren për makinat e ndërtimit. Interesimi i fundit në zhvillimin e HCV-ve dhe burimeve tjera të ripërtrishme poashtu ka vendosur trusni në ngritjen e çmimeve për pajisjet e projektit. Një gabim i mundshëm në vlerësimin e kostos edhe kur bëhen vlerësimet e hollësishme mund të shpien në llogaritjen e pasaktë të tarifës. Si rezultat një tarifë e llogaritur duhet të konsiderohet si e dhënë në vendimin për tarifën fikse dhe jo si diçka përfundimtare.

Nëse ZRrE-ja dëshiron të përdorë qasjen përmes kostos për të përcaktuar tarifën për HCV, duhet të konsideroj se sa ka qen kosto/kW për projekte të ngjashme në Evropë, në veçanti Shqipëria dhe Maqedonia gjatë vitit të kaluar. Kostot e projekteve individuale dallojnë shumë dhe janë shumë të vështira të vendosen gjatë jo-stabilitetit të lartë të tregjeve të produkteve dhe cikleve ekonomike.

Tarifat e llogaritura poashtu tregojnë një tarifë për projektet nën 2 MW pasi marrin një tarifë rreth 60% më të lartë sesa tarifa për HCV-të nga 5 deri në 10 MW. Derisa interesimet e politikës mund të sugjerojnë ndonjë ndryshim për projekte të madhësive të ndryshme, një ndryshim i tillë nuk është i justifikuar. Projektet më të vogla nuk japin ndonjë përfitim të dukshëm nga bashkimi në sistem. Derisa disa argumentojnë se ka efekte më të vogla në ambient, nuk ka ndonjë evidencë të një pohim të tillë jashtë interesimeve për projektet individuale. Pranimi ambientale i projektit dhe kërkesat e projektit për të lehtësuar ndonjë efekt janë një element tjetër i rregullores ambientale dhe agjencioneve që lëshojnë lejet.

Një ndryshim kaq i madh i çmimit ka shumë të ngjarë që të rezultojë në projekte të vogla artificiale, si ndikim ndoshta 4 zhvillime të vogla nga 2 MW në vend të një projekti 8 MW ose projekte që duhet të jenë 3 MW, zhvillohen si projekte 2 MW. Një zhvillim i tillë sigurisht që nuk promovon efikasitet ekonomik.

Vlerësim i kujdesshëm dhe justifikim duhet ti jepet normave të ndryshme që i ofrohen projekteve të madhësive të ndryshme. Nëse ofrohet ndonjë ndryshim, duhet të bazohet në vlerësimet tjera të politikës ose në kostot për furnizimin tensionit më të lartë ose më

të ulët. Në ç'fardo rasti, ndryshimi duhet të jetë shumë më i vogël se 60% në mes klasave të ndryshme të HCV-ve. Një dallim i tillë sigurisht që nuk është i justifikuar në bazë të madhësisë së projektit. Presioni i lartësisë së ujit në dispozicion për një projekt ka lidhje reciproke shumë më të lartë në kosto se në madhësi.

#### 4.5 Nënkuptimi i Tarifën Fikse të Kosovës

Ky informacion jep bazën për vlerësimin të më tutjeshëm të tarifës fikse dhe jep parametra të caktuar për vendosjen e tarifës. Ka disa pika që duhet të konsiderohen si specifike për KEK-un, konsumatorëve të tij dhe furnizimit me energji në Kosovë:

- Koordinimi kohorë mujorë i furnizimit me energji është i rëndësishëm dhe nëse nuk caktohen kufijtë në sasinë e energjisë që japin HCV-të gjatë periudhave me tepriçë të energjisë Prill-Qershor, tarifa për atë periudhë duhet të jetë shumë e ulët;
- Kostot e shmangura të prodhimit janë të vështira për tu përcaktuar, për shkak të natyrës së disa prej uzinave vendore. Kostot e shmangura për uzinat me lignit mund të jen mjaft të vogla;
- Llogaritjet e tarifës në bazë të koston siç është dhënë në Raportin Konsultativë të ZRrE-së janë relevante por vetëm në një aspekt të llogaritjes së tarifës fikse.
- Ndryshimet e mëdha në mes madhësive të ndryshme ose klasave të projekteve ka shumë të ngjarë që të inkurajoj një zhvillim joefikas të burimeve në formën e shumë projekteve të vogla në vend të projekteve të mëdha më efikase. Ndryshimi tarifor në mes klasave të madhësive duhet të pasqyroj më shumë dobi në rrjet, sesa ndryshimi i koston nga studimi hulumtues.
- Një mundësi e pikut duhet tu jepet ndërtuesve për të inkurajuar dizajnin më të përdorshëm për lokacionet e HCV-ve .
- Kostot për blerjen e energjisë elektrike janë relevante për tarifën fikse por blerjet gjatë pikut ditor dhe Sezonale nuk duhet të jenë të vetmit përcaktues pasi që energjia elektrike nga HCV-të nuk do të thotë se i shmangë këto blerje. Këto kosto të blerjes duhet vetëm të jen pjesë e vlerësimit;
- Çmimet e caktuara nga vendet fqinje janë relevante, pasi që ato caktojnë krahasimet. Megjithatë politikat, objektivat e zhvillimit dhe burimet në Kosovë mund të justifikojnë një qasje pjesërisht të ndryshme në tarifën fikse.

Tarifa e propozuar është një kornizë pune reale që ne besojmë se mund më së miri t'i adresoj problemet e KEK-ut dhe të Konsumatorëve të KEK-ut si blerësit përfundimtar. Niveli i çmimit të kornizës së punës llogaritet me çmimet tjera të Evropës dhe rajonit të Ballkanit por adreson një problem në Kosovë me energjinë e furnizuar nga rrjedha e lumit atëherë kurë është më së paku e nevojshme.

## 5. Korniza Alternative e Punës e Propozuar

Një kornizë pune e propozuar është dhënë për konsideratën e ZRrE-së.

### 5.1 Elementet Përmbledhëse të Kontratës

- Feed-in tarifa e kornizës së punës mbetet si çmimi më i lartë i mesatares së çmimit të blerjes së energjisë elektrike të 3 viteve ose ndonjë tarifë alternative.

- Tarifa më e lartë është paguar nga korriku deri në Mars;

-50% e tarifës më të lartë është paguar nga Prilli në Qershor;

Nëse do kishte konkurrencë për lokacionet, një garë tenderuese do të thërriste për zbritje nga tarifa më e lartë:

-Feed-in tarifa më e lartë fillestare do të ishte rreth €83/41.5/MWh për dy periudhat.

Rezultati është një çmim i lartë i zbutur rreth €72.63/MWh –nëse energjia e dhënë është e njëjta gjatë tërë vitit. Nëse 50% e energjisë jepet gjatë çerekut të dytë Prill-Qershor, tarifa e zbutur zbret në €62.1/MWh.

Çmimi to të përcaktohet pa ndryshme për 10 vitet e ardhshme pasi që jepet tenderi me koncesion, duke paramenduar 1 vit planifikim/lejet dhe 1-2 vite ndërtim duke lënë kështu 7-8 vite veprimtari;

Ngarkesat për kyçje duhet të jen përgjegjësi e ati që e merr me koncesion sipas propozimit të rregullores së ZRrE-së;

Në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike, ai që e merr me koncesion do të ketë një opsion të pikut që do të jepte një premium 50% mbi normën e liferimit të energjisë elektrike gjatë periudhave 7-9 paradite dhe 5-10 pasdite dhe 60% e normës për orët tjera. Ai që e merr me koncesion duhet të dorëzoj planet e projektit që tregojnë se pikut është i mundshëm.

### 5.2 Avantazhet e Kornizës së Punës

- ka mundësi të jetë i mjaftueshëm për të tërhequr konsumatorët

- I inkurajon ofertuesit që ta formulojnë projektin që të jetë me vlerë për konsumatorët e KEK-ut;

- I Thjesht dhe transparent;

- Adreson problemin e furnizimit hidrologjik/burimin në mënyrë të thjesht

- Inkurajon kushtet për energji elektrike më të vlefshme në pik/sezonale

Supozimet e Kornizës së propozuar të Punës përfshinë:

1. KEK-u do e blej të gjithë energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtrishme ose nga bashkë-gjenerimi
2. Ndërtuesit e gjenerimit të ripërtrishëm do të jenë përgjegjës për ndërtimin e linjave të liferimit dhe për kostot për kyçje në bazë të procedurave dhe tarifave të ZRrE-së;
3. Çmimet blerëse duhet të unifikohen dhe të caktohen nga ZRrE-ja;
4. Kostoja e blerjeve nga HCV-të do të përfshihet në Kostot e Lejuara të KEK-ut të cilat do të paguhet nga konsumatorët.

Brengat kritike të KEK-ut përfshinë:

1. Nëse është e mundur të shmanget blerja e energjisë elektrike nga shumica e HCV-ve gjatë kohëve të panevojshme, jashtë pikut

- DHE nëse është e mundur të shmanget të blerja gjatë muajve të rrjedhave të mëdha në Ballkan, Prill deri në Qershor.;
2. Të shmanget pagesa e një norme nxitëse ose normë premium për energjinë elektrike që nuk mund të përdoret (p.sh. gjatë periudhave jashtë pikut);
  3. Të Inkurajohet zhvillimi i energjisë elektrike të përdorshme;
  4. Të shpërblehet energjia elektrike e përdorshme dhe në pik.

Paragrafët në vijim japin një elaborat të elementeve të strukturës së punës

Struktura e Feed-in tarifës mbetet si çmimi më i lartë i mesatares së energjisë elektrike të blerë në 3 vitet e fundit.

Blerja e energjisë elektrike nuk do të thotë se është parametri i vetëm ose më i mirë i caktimit të Feed-in tarifës. HCV-të tradicionale nga rrjedha e ujit nuk do thotë se e zëvendësojnë blerjen e energjisë elektrike; e në veçanti në muajt kur ka në dispozicion vetëm pak ujë. Çmimet janë të diktuara nga tregu dhe janë subjekt i shumë trusnive jashtë Kosovës dhe nuk janë të lidhura me kostot e ndërtimit të HCV-ve. Çmimet janë ngritur në mënyrë dramatike gjatë tri viteve të kaluara. Çmimet e energjisë dhe energjisë elektrike nuk janë stabile dhe mund të ndryshojnë shpejt. Situata energjetike në Ballkan ka mundësi që të jetë e kufizuar për ca kohë, dhe ka shumë mundësi të rezultojë vazhdimin e çmimeve të larta të energjisë elektrike.

Përdorimi i një mesatare tre vjeçare për çmim do kishte tendencë në minimizimin e pikve lugjeve derisa vëzhgohen trendet afatgjata. Poashtu rezulton në një tarifë që është në përputhshmëri me tarifën e tanishme Evropiane dhe tarifën e vendeve Ballkanike, e në veçanti në vendet fqinje Shqipëri dhe Maqedoni. Për më tutje, tarifa është propozuar si tarifa më e lartë, me caktimin e tregut të normës së tanishme për një projekt të caktuar përmes procesit të tenderimit të MEM-it me koncesion. Lokacione më konkurrense do të tërheqin zbritje nga çmimet më të larta derisa lokacionet më pak konkurruese mund të tërheqin oferta me çmim të plotë ose asnjë ofertë. Tregu mund të zgjedh projektet më të mira dhe fus ata në përzierjen e gjenerimit me një çmim të përshtatshëm për konsumatorët e KEK-ut.

- **Tarifa më e lartë paguhet nga Korriku deri në Mars;**
- **50% e tarifës më të lartë paguhet nga Prilli deri në Qershor;**

Siç është cekur më lartë në këtë dorëzim, KEK-u është shumë i brengosur për konvergencën e ujit të lartë dhe prodhimi nga HCV-të me rrjedhje të lumit DHE, periudhën e nevojave më të vogla të energjisë në tregun e Kosovës dhe Ballkanit. KEK-u edhe ashtu ka probleme në shpërndarjen e energjisë elektrike jashtë pikut në muajt e pranverës. Nëse nuk ka ndryshime në çmim, KEK-u mund të jetë i shtyrë të blejë energji elektrike me çmim të lartë dhe në fund ta shes apo ta gjuaj atë në tregun ndërkombëtar në periudhën jashtë pikut me çmim shumë më të ulët se ai i blerjes. Si shtesë, tregu dënon financiarisht furnitorët kur shumë energji elektrike hidhet në sistem, duke e bërë kështu çmimin e hedhjes edhe më të ulët.

Injorimi i problemit të mundshëm të tej-prodhimit nga hidro në caktimin e tarifës së HCV-ve do të shkojë që KEK-u të ketë një burim tjetër negativ të rrjedhës së parasë, në një periudhë kur komercializimi dhe privatizimi është prioritet i lartë.

Ndarja e tarifës në sezon të lagët dhe sezon të thatë nuk është bërë në rajonin e Ballkanit por është bërë diku tjetër, aty ku hidrologjia dhe kërkesa për energji elektrike nuk përputhen. Situata e secilit vend ndryshon. Në Shqipëri, ekzistojnë rezervat të mëdhenj të grumbullimit të cilët shpesh mund të ciklohen prapë në prodhimin e HCV-ve. Ekzistojnë disa hidro projekte të mëdha në Maqedoni që mund të operojnë në mënyrë të ngjashme. Megjithatë në Kosovë gjenerimi nuk është i gatshëm për ciklim. Mungesa e mundësisë për ciklim nga termo blloqet e energjisë elektrike të Kosovës e bëjnë operimin e sistemit të vështirë. Hedhja e gjenerimit nga HCV-të mbi njësit ekzistuese të cilat duhet të punojnë për të arritur piket në këtë periudhë e përkeqësojnë situatën. KEK-u rekomandon të paguhet 50% e tarifës së HCV-ve për sezonën e lagët dhe pjesën e vitit me tepriçë të energjisë. Një strukturë e tillë tarifore ose do t'i shtyj ndërtuesit që të formulojnë projektet e tyre për të maksimizuar vlerën e energjisë elektrike të blerësi (KEK-u) ose t'i zhvillojnë projektet e tyre për të maksimizuar të hyrat. 50% e tarifës me çmim më të lartë gjatë periudhës Prill-Qershor pasqyron realitetin e sistemit operativ dhe realitetet e tregut. Mos adresimi i këti problemi të mundshëm është të dënosh konsumatorët e KEK-ut me obligime shumë jo-ekonomike dhe afatgjata. Ky problem nuk ka aspak të bëjë me normën nxitëse për të tërhequr ndërtuesit.

**- Feed-in tarifa më e lartë fillestare do të ishte rreth €83/41.5/MWh për dy periudhat. Rezultati është një çmim i lartë i zbutur rreth €72.63/MWh –nëse energjia e dhënë është e njëjta gjatë tërë vitit. Nëse 50% e energjisë jepet gjatë çerekut të dytë Prill-Qershor, tarifa e zbutur zbret në €62.1/MWh.**

Shumica e rrjedhjes së lumenjve në Kosovë arrin pikun në periudhën Prill-Qershor. Si të tilla HCV-të do të japin më shumë energji elektrike në atë çerek sesa në çerekët tjerë. Nëse uzinat do të ndërtoheshin në madhësi të cilat do kishin prodhim të dukshëm në këto rrjedha, në vend të nëntë muajve tjerë kur energjia elektrike është e pakët, shumica e prodhimit nuk do të hynte në punë. Norma më e lartë €83/MWh mund të duket ca si e lartë dhe është më e lartë se ajo në Raportin Konsultativë të ZRrE-së. Megjithatë norma fillon të bjer dukshëm kur konsiderohen ndikimet e mundshme të hidrologjisë. Është e pamundur që ndonjë HCV të marrë një normë të zbutur që pasqyron liferim të barabartë të energjisë gjatë të gjitha çerekeve, ose €73.63/MWh. Ka më shumë mundësi që HCV-të do të kenë 50% ose më shumë energji elektrike në atë çerek, që rezulton në normë rreth €62.25/MWh. Nëse liferimi matet në pranverë atëherë edhe më keq, norma do të jetë më e ulët.

Strukturimi i tarifës mes periudhave të lagëta dhe të thata për të tërhequr më shumë projekte me vlerë është shumë me rëndësi për konsumatorët e KEK-ut.

**Çmimi do të jetë në rregull për 10 vitet pasi që jepet tenderi me koncesion, duke paramenduar 1 vit planifikim/lejet dhe 1-2 vite ndërtim duke lënë kështu 7-8 vite veprimtari;**

Në mënyrë që ndërtuesit të kenë një siguri investime duhet të ketë një sigurim të tarifës. Kështu që, ne propozojmë që tarifa fillestare të përcaktohet për një periudhë 10 vjeçare nga dita e lëshimit të licencës ose koncesionit. Deri në kohën kur lëshohet ndonjë licencë ose koncesion të lëshohet në fillim të vitit 2009, çmimi i plotë i energjisë elektrike të blerë për 2008 do të përcaktohet dhe mund të përdoret për një mesatare tri vjeçare. Koncesionet duhet të nënshkruhen para fundit të vitit 2009 dhe të vlejnjë për 10 vite. Pasi që normës ti kalon afati pas 10 vitesh, ndërtuesi e ka nxitjen për të kompletuar planin e

veprimtarisë sa më shpejt që të jetë mundur. Megjithatë kontratat mund të bëhen të vazhdueshme pas ç'do periudhe 5 vjeçare.

Një përcjellje e normës duhet të vendoset nga ZRrE-ja për periudhën pas kalimit të normës fikse. Supozojmë që norma do të jetë më e ulët se norma nxitëse e propozuar këtu. Një sugjerim do ishte të kemi një krahasim të tregut për vazhdimin e HCV-ve i caktuar për të gjitha uzinat pas kalimit të periudhës fikse, bazuar në përqindjen e caktuar të kostos të energjisë së blerë ose ndonjë produkti tjetër relevant.

***Ngarkesat për kyçe duhet të jen përgjegjësi e ati që e merr me koncesion sipas propozimit të rregullores së ZRrE-së***

Në përputhje me të gjitha rregullat e propozuara nga ZRrE për interkoneksion dhe normat e vendosura në shumë vende, ai që e merr me koncesion do të paguaj për kostot e linjave për kyçes dhe interkoneksionin, duke përfshirë pajisjet matjen, ndërrimin dhe kontrollin e nevojshëm për projekt.

***Në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike, ai që e merr me koncesion do të ketë një opsion të pikut që do të jepte një premium 50% mbi normën e liferimit të energjisë elektrike gjatë periudhave 7-9 paradite dhe 5-10 pasdite dhe 60% e normës për orët tjera. Ai që e merr me koncesion duhet të dorëzoj planet e projektit që tregojnë se piku është i mundshëm.***

Konsumatorët e KEK-ut do të përfitojnë duke pasur energji elektrike që ndihmon në operimin e sistemit, sesa energji elektrike e cila duhet patjetër të shitet ose të konsumohet gjatë periudhave me tej-furnizim. Nëse ndërtesat mund të japin energji elektrike në pik duke pasur rezerva për rrjedhën e gjenerimit, ata duhet të marrin një nxitje të dukshme. Ne propozojmë një normë opcionale të pikut për HCV-të, bazuar në normën më të lartë. Sipas propozimit tonë, një ndërtesë që mund të furnizoj rreth 30% më shumë energji elektrike në pik sesa në plani me rrjedhë të lumit do të përfitoj nga stimulimi. Norma më të larta do të jenë tërheqëse për konsumatorët e KEK-ut.

***-Shtojcë informative***

Tabela e bashkangjitur është nga një prezantim i titulluar "Struktura Politike e Hidro-energjisë së vogël në Shtetet e reja anëtare të BE-së dhe Vendeve Shoqëruese" raporti është nga Petras Punys nga Shoqata Lituanëze e Hidro-energjisë. Është prezantuar në vitin 2007 dhe i ka nivelet e feed-in tarifave për krahasim. Shumica e këtyre tarifave janë rritur për vitin 2008, e disa dukshëm. Tabela është paraqitur për informim. Tregon se Struktura e Propozuar për Feed-in tarifën për HCV-të për këtë raport nuk është jashtë reales, e në veçanti konsiderohet sezona e tarifës. Poashtu paraqet ndryshueshmërinë e tarifës nga një vend në tjetrin.

Referencat:

1. Vendimi i Qeverisë së Kosovës 05/250 i datës 16 Maj 2007; "Masat nxitëse për gjenerimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtrishme dhe bashkë-gjenerimi."
2. Studimi Paraprak mbi Përshtatshmërinë e Zhvillimit të Hidrocentraleve të Vogla nga Shoqata Shqiptare e Energjisë dhe Ambientit për Zhvillim të Qëndrueshëm – 22 Maj 2006
3. Prezantimi PowerPoint në Mundësit Politike për Zhvillimin e Energjisë së Ripërtrishme – Mars 2007 ; EPTISA për Mbështetjen e MEM-it
4. Informacioni i Ngarkesës për 2005-07– Zhvilluar nga KEK me ndihmën e PA-së

5. Web Faqja e Ministrisë së Ekonomisë së Maqedonisë – Tenderi për Hidrocentralet e Vogla Q&A

Tabela e bashkangjitur është nga një prezantim i titulluar "Struktura Politike e Hidro-energjisë së vogël në Shtetet e reja anëtare të BE-së dhe Vendeve Shoqëruese" raporti është nga Petras Punys nga Shoqata Lituaneze e Hidro-energjisë.

